



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 105, Datë 26.06.2019

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “TERNA ENERGY TRADING” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.06.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 61, datë 10.05.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Pas kësaj vendimarrje, ERE me shkresën nr. 32/22 Prot., datë 10.05.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Terna Energy Trading” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr.302/1 Prot., datë 16.05.2019, ERE dërgoi pranë shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit i cili konsistonte në mungesën e dokumentit, Vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vërtetim i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për administratorin e kësaj shoqërie.
- Në përgjigje të kërkesës së ERE-s, shoqëria “Terna Energy Trading” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr.302/2 Prot., datë 13.06.2019

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr.302/4 Prot., datë 20.06.2019, ka plotësuar tërësisht këtë dokumentacion.
- Aplikimi i shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - **Formati dhe dokumentacioni për aplikim** (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor** (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Dokumentacioni financiar dhe fiskal** (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike** (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Terna Energy Trading” sh.p.k në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5(pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI